



VENDIM

Nr. 55 Datë 03.08.2009

PËR

**MIRATIMIN E “KONTRATËS PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË KESH SH.A (FURNIZUESI
PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË OSSH SH.A (FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 01.01.2009
DERI MË 31.12.2009**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 26, pika 1, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar; te neneve 111 dhe 112/2/b, te Kodit te Procedurave Administrative, te miratuar me Ligjin nr. 8485 date 12.05.1999, pikes 4.13 gërma”A”, pika 2, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, te miratuar me VKM nr.338, datë 19.03.2008, pikës V.1, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.68, dt.23.06.2008, Vendimit nr.22, date 18.03.2009 “Per fillimin e procedurave te miratimit te kontrates se furnizimit midis KESH sh.a dhe OSSH sh.a, Bordi i Komisionereve te Entit Rregullator te Energjise ne mbledhjen e tij te dates 03.08.2009, pasi diskutoi mbi draftin e kontratës “Për furnizimin me energji elektrike ndermjet shoqerise KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumice) dhe shoqerise OSSH sh.a (Furnizuesit Publik me Pakice) per periudhen 01.01.2009 deri me 31.12.2009“,

Konstatoi se :

- Kontrata është lidhur nga KESH sh.a dhe OSSH sh.a, subjekte të licensuara nga ERE, përkatësisht me vendimet Nr. 11 datë 23.06.2006 dhe Nr. 9 datë 25.01.2008, të ndryshuar,
- Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike dhe Rregullat e tregut të energjisë elektrike përcaktojnë se kjo kontratë i nënshtrohet tregut të rregulluar



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



- Në referencë të akteve të sipërcituara, ERE është autoriteti i përcaktuar për miratimin e kësaj kontratate,

Për sa më sipër evidentuar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e kontratës “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a (Furnizuesit Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2009 deri më 31.12.2009 me ndryshimin në nenin 8, pika 1, si më poshte:

Neni 8 pika 1,

Mbas fjalës “*një shumë*” të shtohet paragrafi: ***të barabartë më kostot/shpenzimet shitesë, të arsyeshme, të argumentuara dhe të verifikueshme që pëson pala pranuese Furnizues Publik me Pakicë (FPP) si pasojë e paaftësisë për livrim energjie elektrike tek konsumatorët tariforë.***

2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë KESH dhe OSSH për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.55 Datë 03.08.2009

PËR

**MIRATIMIN E “KONTRATËS PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË KESH SH.A (FURNIZUESI
PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË OSSH SH.A
(FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 01.01.2009
DERI MË 31.12.2009**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkeqim Bozgo	_____	_____